

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPŠTINA OPŠTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal

Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e Parë të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më 30.01.2025 (E enjete) duke filluar në ora 10:00.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Raporti i punës së Kuvendit për vitin 2024;
3. Informimi i Propozim planit për mbajtjen e mbledhjeve të K.P.F-së gjatë vitit 2025.
4. Informimi i propozim planit të punës së kuvendit për vitin 2025;
5. Të ndryshme;

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:21.01.2025
Në: Novobërdë

Kryesuese e Kuvendit
Mirjana Simijonović





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e njëmbëdhjetë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 23.12.2024, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj. Mirjana Simijonovic, antarët e Kuvendit: Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu, Dobriboje Djordjevic, Vlora Vllasaliu, Violeta Milosevic, Ivana Ivanovic, Milica Jovanovic, Nënkrjetari i komunes zt. Bajrush Ymeri, Zyrtarja për Informim zonj. Valdete Bunjaku, Zyrtarja për shërbime Publike zonj. Shefkije mehmeti, përfaqësuesi i OSBE-së, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Kryesuesja e Kuvendit pasi pershendeti të pranishmit tha: konstatoj korumin prezent janë 14 antarë nga 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

R e n d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Shqyrtimi i Rregullores për transparenc komunale;
3. Shqyrtimi i Listes (shitesë e listes së parë) të pronave komunale për shfrydzim për vitin 2025;
4. Raporti i DSHP-ës për mirëmbajtjen e rrugve gjatë sezones dimrore(propozim i komitetit për komunitete);
5. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti të pranishmit se a keni me shtu ndonje pikë tjeter ,fjalën e mori antari i kuvendit Stojan Stanojevic;ju pershendes të gjithëve ,po une kamë nje propozim e per ket po bazohena në rregulloren e punes se kuvendit në nenin 16 pika dy ku thotë se anëtarët e kuvendit kanë te drejt të fusin në rend dite nje pikë e unë kerkoj që ne këtë rend dite të diskutohet per rrugen Prekoc Strazh Stanishor,dhe të bihet një vendim që ti kerkohet nga Ministria e Infrastruktures që te bëhet sanimi i Rruga Prekoc,Zebinc ,Stanishor,ju faleminderit kaq kisha.

Kryesusja: pra ti po kerkon qe ta fusim në rend te dites piken ,
Prueja e Vendimit per Sanimin e rruges Prekoc,Zebinc,Stanishor dhe ti dergohet ministris së Infrastruktures.

Kryesusja ,a ka edhe dikush nese jo atëhere po e qes në votim,piken qe e propozoj kolegu Stojan Stanojevic kush është qe kjo pik të hinë në rendin e dites,konstatoj se nga 14 antar prezent te 14 janë pro,atëhere e fusim në rend te dites si pika e past ndersa pika të ndryshme kalon në piken gjashtë.

Pasi nuk pati propozime aprovohet njëzëri rendi i ditës.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Pasi nuk pati vërejtje procesverbali u aprovua njëzëri nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e dytë: Shqyrtimi i Rregullores për transparenc komunale;

Fjalën ja dha zyrtares për Informim zinjës Valdete Bunjaku ku ajo pasi pershendeti të pranishmit tha se në bashkpunim me ministrin kemi pregaditur këtë dreft rregullore për transparenc komunale dhe pas diskutimeve dhe debateve që kemi pasur me qytetaret sot kamë pruar këtë rregullore për miratim në kuvend andaj kërkoj nga ju që ta miratoni rregulloren ,ju faleminderit për mirëkuptim.

Kryesuesja kush donë të flas për këtë temë.

Abdyl Gashi ju pershendes dhe deshta me u nderlidhë me këtë rregullore dhe unë personalisht e perkrahu këtë rregullore dhe se deri me tani nuk kemi pasur transparenc dhe se asnjë herë qytetaret nuk kanë ditur se qfar vendime ne votojm ne si asambleist.

Kryesuesja a don edhe dikush të flas.

Pasi nuk pati diskutime kaloi në votim kush është po.

Kryesuesja , Konstatoj se nga 14 antar prezent me 14 vota pro kalon pika e parë.

Kalojmë në piken e tretë.

Pika e tretë: Shqyrtimi i Listes (shtesë e listes së parë) të pronave komunale për shfrydzim për vitin 2025; Kryesuesja e hapi materialin e kemi vetem në gjuhën serbe atëhere propozoj që të kalojmë në piken e katert e mast të na vie materiali i kthehemi pikes së tret e diskutojmë.

Pika e katërt: Raporti i DSHP-ës për mirëmbajtjen e rrugve gjatë sezonës dimrore(propozim i komitetit për komunitete);

Kryesuesja, për këtë pikë kemi zyrtaren për shërbime publike zonjen Shefkije Mehmeti urdhero.

Ju faleminderit kryesuse ju pershendes të gjithëve në si drejtori deri me tani nuk kemi mundur të bëjm shpalljen më heret për mirëmbajtjen e Rrugve gjatë sezonës së dimrit ,tani në këtë muaj ne kemi shpallur tenderin dhe presim që ta nënshkruajm kontratën me operatorin ekonomik vlera e kesaj kontrate është 9 mij euro,ne si komunë kemi një traktor që mendojmë edhe me të ti pastrojm rrugët nga bora.

Ju faleminderit nese ka ndokush ndonjë pyetje urdheroni jam e hapur për diskutim.

Dobri voje Djoedjevic pershendet për të gjithë kolegët ,kjo pik ka ardhur nga komiteti për komunitete ku edhe unë jam antar i këtij komiteti dhe se ,më se shumti lidhet me problemin e rruges Prekoc Zebinc Stanishor dhe pytja ime është se kush do ta mirëmbaj këtë rrug kjo kompani që kemi kontraktuar ju apo kompanit e zgjedhura nga ministria e Infrastruktures pasi kjo rrugë është Regjionale.

Shefkije Mehmeti po ajo rrugë mirëmbahet nga kompanija regjionale e kontraktuar nga ministria por ne nuk kemi pasur asnjë herë kërkes ose ankes se kjo kompani nuk e pastron këtë rrugë.

Unë kamë pasur pas ankes se rruga prej Bostanit deri në Novobërdë nuk pastrohet dhe ju kamë bër vërejtje edhe ministris edhe kompanis dhe se tani kjo rrug mirëmbahet.

Kryesuesja Shefkije unë mendoj se mëse pari të ndalen makonerit e rëndë pastaj të asfaltohet se është shumë e demtuara e pastaj të behet mirëmbajtja dimrore .

Shefkije mehmeti i nderuar rrugët regjionale si llabjan novoberd,Boston Stanishor,Prekoc Stanishor tenderi për mirëmbajtje shpallet nga Ministria jo nga komuna.ne si komunë nese kemi vërejtje duhet ti dergojm vërejtjet me shkrim ministris se kjo kompani e përzgjedhur nuk po e kryen punën si duhet.

Kryesuesja a ka edhe dikush të shtoj diçka, nese jo kalojm në piken e perst te rendit të dites .

Pika e Pestë: Prueja e Vendimit për Sanimin e rruges Prekoc,Zebinc,Stanishor dhe ti dergohet ministris së Infrastruktures.

Kjo pikë është propozuar nga kolegu Stojan Stojanovic urdheroni koleg .

Stojan Stojanovic pasi pershendeti të pranishmit tha se kohet e fundit mendoj se sahere kemi pasur seanc ky problem i kesaj rruge është diskutuar dhe se nuk po mund ta zgjedhim ,dhe unë mendoj se ne si kuvend të marrim një hapë konkret qe ta bime një vendim qe ministris së infrastruktures ti bejm nje kerkes me shkrim ,unë nuk mendoj qe menjehere do te ralizohet kerkesa qe kjo rrug të asfaltohet por unë mendoj se kjo ashtë nje garanci qe ne habin e dyt te kemi nje garanci ,ne ketë vitë ne kemi pasur bllokimin e rruges nga qytetaret në fshatin Strazh por mendoj se kjo nuk ka dhan rezultat .

Kryesusja ne si kuvend komunal ju kemi berë shkresa por deri me tani nuk kemi marrur asnje pergjegjje Ramush mehmeti ju faleminderit kryesuese ,unë e perkrahu plotsisht dhe mendoj se ashtë mirë qe per her te parë nga kuvendi komunal po i behet nje kerkes per ketë rrug .

Kryesusja a ka edhe dikush me fol nese jo e hodhim në votim kush është pro. Konstatoj se me 14 vota pro kalon ky propozim.

Kalojm në piken tjeter të rendit të dites pra kthehemi në piken e tret të rendit të dites se edhe materjaki ka ardhur në te dy gjuhet ,a kini nevoj per pauz? Pra nje pauz prej 5 mintave dhe pastaj kthehemi në piken e tret të rendit të dites qe e anashkaluam per shkak materjalit qe nuk ishte ne dy gjuhet.

Pika e tretë: Shqyrtimi i Listes (shtesë e listes së parë) të pronave komunale për shfrydzim për vitin 2025; Kryesusja para se të fillojm me rendin e dites po ja jap fjalen nënkryetarit zt.Bajrush ymeri e pastaj fillojm me rendin e dites.

Bajrush ymeri;tënderuar antar të asambles komunale i nderuara kryesuse zv kryesus perfaqesues të osbesë me lejoni të flas para jush per nje temë qe vetem në komunën tonë ka mbetur pa perfunduar e ajo ashtë emrimi i rrugve .

Ju e dini qe kemi themelu një komision per emrimin e rrugve ,ne kemi pasur takime me agjensionin e kadastrit me kryeshefin e agjensionit në zyren e kryetarit në gushtë te keti viti dhe kemi marëur obligime qe proqesin e emrimit të rrugve me perfundu,dhe fatkeqsisht diqka e tillë nuk ka ndodhur pra nukjanë perfunduar emrimi i errugve dhe afati i fundit po afrohet dhe data e fundit është me 31.01.2025,komuna e jonë gjithsej ka 173 rrugë dhe 4430 hyrje si shtepi lokale etj.të dhenat per keto rrug dhe hyrje janë te ruajtura në bazen e të dhënave qe quhet aidis të cilet kanë qasje zyrtaret e urbanizmit dhe kadastrit pra jemi komuna e vetme qe nuk kemi bërë emertimin e rrugve ,pra e vetmja komun qe nuk ka ber vendosjen e tabelave per emrimin e rrugve dhe të hyrave të ndertesave,komunat tjera ketë janë në procese të vendosjes.

Emertimi i rrugve siq e dini është obligim ligjor qe duhet bër me agjensionin katastral të kosoves,emertimi i rugve inicohet permes drejtoris se kadastrit dhe formohet ne komision qe ne e kemi themeluar me kohë dhe ky komision ka ber takime me banoret e fshatrave dhe janë marrur me emrat per emertimin e rrugve. Komisioni ka ber nje list të cilen list duhet ta miratoj kuvendi komunal ,komisioni ka dorzuar nje list me emrat e rrugve në agjensionin katastral të kosoves ku më pas na janë kthyer me disa vrejtje dhe rekomandime të ndryshme ,qellimi i ketyre kriterëve është qe të ndihmon komisionin qe të jetë emertimi konform kriteve të kerkuara .

Rekomandimet per ndryshim janë dhënë per 54 rrugënga 173 sa janë gjithsej propozimet emrat e dhënë janë konkretisht qe i kanë marrë per bazë edhe strukturen etnike,gjeografike,etnologjike,kulturore etj.

Disa rekomandime nga keto janë me te lehta qe mund te permisohen e disa te tjera janë qe patjeter të ndryshohen por qe nje anishum procesi nuk është duke hecur prandaj ne duhet me u mundu me tejkalu ketë situat,rekomandimet janë te leta se kanë te bajn me ndryshime si per shembull:ju si komision keni derguar emra në alfabetin cirilik dhe rrug me alfabetin cirilik duhet ta dini qe nuk pranohen,pastaj ka rrugë qe janë emruar me dy emra si pershembull Ognjanska në fshatin koretisht me te njejtin emer edhe në fshatin Carevc po ashtu kemi edhe të komuniteti shiptar si shembull rruga nëna terez në f.sh.llabjan po

Procesverbali i Kuvendit

ashtu edhe në fshatin pasjak është emru nje rrug me ketë emer ,po shtu kemi edhe disa emra të lagjeve qe duhet të ndryshohet si lagjeja Abazaj,Degellaj ,behovit qe duhet të ndryshohet.

Pika e gjashtë: të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin.

Stojan Sonajovic tha: si pikë për mbledhjen e ardhshme të dergohet në Ministri dhe Drejtorisë së Urbanizmit se pse spo mirret asgjë për rrugën në Prekovc.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse

Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Kryesuesja e Kuvendit Komunal
Zonj: Mirjana Simijonovic



**RAPORT I KRYESUSES SË KUVENDIT PËR PUNËN E KUVENDIT PËR VITIN
KALENDARIK 2024**

Janar 2025

Të respektuar/a
Anëtarë/e të Kuvendit Komunal të Novobërdës.

Ju drejtohem si Kryesuse e Kuvendit të ju raportoj për punën një-vjeçare të Kuvendit Komunal të Novobërdës, duke i përmbledhur rezultatet në çdo fushë, kështu edhe Kryesusja e Kuvendit ka obligim që për punën vetë dhe të Kuvendit ti njoftoj ata me të cilët së bashku punuam për të përmisuar kualitetin e punës, si dhe të gjithë atyre që janë të lidhur me Kuvendin pa të cilët nuk mundet të punojmë dhe realizoj qëllimet e tona: Kryetarin, Drejtorët, Ministrin kompetente e në fund edhe ata që janë më të rëndësishmit e na kanë dhënë besimin, që t'i prezentojmë në këtë organ, e ata janë qytetarët e Komunës sonë.

Gjithashtu kam knaqësinë që jamë në krye të një Kuvendi multietnik, për të cilën mundë lirishtë të them që paraqet një shembull të mire të bashkpunimit në mesë të Këshilltarëve të Komuniteteve të ndryshme ku në planin e parë është bashkëpunimi në mesë të anëtarëve të komuniteteve të ndryshme, dhe kanë për qëllim realizimin e kushteve më të mira të jetës për qytetarët e vetë.

Siç është e ditur Kuvendi Komunal mbështetet në aktet juridike, duke filluar nga Ligji për Vetqeverisjen Lokale, si aktin më të lartë e përmes statutit si aktin më të rëndësishëm të Komunes, rregullores së Kuvendit dhe akteve tjera që i aprovon Komuna. Në këtë drejtim në bazë të nenit 43.2, Ligjit për Vetqeverisje Lokale, si dhe nenit 43.5 të statutit, Kuvendi i Komunës është e obliguar t'i mbajë dhjetë mbledhje të rregullta gjatë vitit, edhe atë gjashtë në pjesën e parë të vitit dhe gjashtë në pjesën e dytë. Me knaqësi mundë të konstatoj se kemi vepruar në bazë të nenit 43.2 LVL, si dhe nenit 43.5 të statutit në kuptimin e përmbajtjes së afateve për mbajtjen e mbledhjeve.

Kuvendi Komunal ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta dy degjime publike me qytetarët e komunes ku në keto degjime publike ka pasur një numër të konsiderueshëm të qytetarëve.

Gjatë ketyre dymdhjet seancave kemi diskutuar shumë tema të ndryshme ku temat që mëse shumti ka pasur diskutime nga ana e anëtarëve kanë qenë temat që janë diskutuar për: Rrugen prekoc-Strazh - Stanishor, tem tjetër e diskutimit kanë qenë edhe Gurthyesit që operojnë në territorin tonë ku unë së bashku me kryetarin e komunes dhe në bashkpunim me Agjensionin për Minjera dhe Minerale kemi pasur takim të përbashket me kompanit dhe qytetarët e fshatrave si Strazh, Stanishor, Koretisht, ku këta qytetar kanë protestuar dhe kanë mbyllur rrugen për kalim etj.

Të gjitha mbledhjet janë mbajtur në bazë të planit vjetor të punës dhe anëtarët janë njoftuar me kohë 7 ditë para mbledhjes siq është e cekur në nenin 43.3, të LVL.

Në mbledhjet e rregullta të mbajtura kemi aprovuar:


46 vendime, një Rregullore (Rregullorja për Transparenc Komunale) dhe të gjitha janë verifikuar nga ana e Ministrisë kompetente për vetqeverisje lokale.

Kuvendi përveq mbledhjeve të rregullta të Kuvendit kemi mbajtur edhe mbledhje të rregullta të Komitetit për Politik dhe Financa ku për këtë viti i kemi mbajtu 12 mbledhje që do të thotë se para çdo mbledhje të Kuvendit kemi shtejlluar njëher pikat në KPF-ë.


Po ashtu edhe komiteti për komunitete ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta ku ka diskutuar tema të ndryshme ,ku disa prej pikave të rendit të dites janë propozuar nga ky komitet që të shkojnë për diskutim edhe në KPF dhe Kuvend, për qka edhe jemi falenderues.

Të nderuar antarë të Kuvendit në fundë të këtij raporti deshiroj t'ju falenderohem për bashkpunimin dhe kontributin e juaj në punën e Kuvendit. Çdo propozim u juaj është i mirëseardhur, shpresoj që në këtë vit të kemi edhe më shumë bashkpunim me Këshillin Egzekutiv dhe me angazhimin tone, me sjellje të mirfilltë mundemi të realizojmë rezultate më të mira në Kuvendë ku e gjithë kjo do të reflektohet në përmisimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët, dhe shërbimet tjera si dhe ngritja e nivelit të infrastruktures Komunale.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së
Novobërdës



Mirjana Simijonovic



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

DATE/A:	15.Janar.2025
PËR/ZA/TO:	Antarët e K.P.F-së /Clan K.P.F
NGA/OD/FROM:	Mirjana Simijonovic – Kryesuese e Kuvendit/ Presedavajica Skupstine
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim orari për mbajtjen e mbledhjeve të K.P.F-së për vitin 2025 Predlog redosleda za održavanje sastanaka K.P.F-je za 2025g


Të nderuar,

Në bazë të nenit 43.6 të Statutit të komunës, po ju dërgoj propozim kopjen e orarit për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politik dhe Financa për vitin 2025.

Postovani,

Na osnovu clana 43.6, Statuta Opstine, saljem vam predlog kopiju redosleda održavanja sastanaka Komiteta za Politiku i Finacije, za 2025g.

Nr/ Br	Dita Dana	Data Data	Koha Vrem	Vendi Mesto
1.	E matre Utarak	21.01.2025	10:00	Salla e K.K Sala S.O
2.	E merkur /Sreda	19.02.2025	10:00	Salla e K.K Sala S.O
3.	E martë /Sreda	19.03.2025	10:00	Salla e K. K Sala S.O
4.	E premte Petak	18.04.2025	10:00	Salla e K.K Sala S.O
5.	E martë Utarak	20.05.2025	10:00	Salla e K.K Sala S.O
6.	E enjte Cetvertak	19.06.2025	10:00	Salla e K.K Sala S.O
7.	E hënë Ponedelak	21.07.2025	10:00	Salla e K.K Sala S.O
8.	Pushim Odmor	pushim	////////	
9.	E merkure Sreda	17.09.2025	10:00	Salla e K.K Sala S.O
10.				
11.				
12.				



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

DATE/A:	20.12.2024
PËR/ZA/TO:	Antarët e Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	Mirjana Simijonovic – Kryesuese e Kuvendit Predsedavajuca Skupstine
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i punës së Kuvendit

Në bazë të nenit 12 paragrafit 2 pika d), dhe nenit 40, paragrafi 1 dhe 2, pika d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale dhe në bazë të nenit 34 pika 5 të statutit të Komunës së Novobërdës nr.01-992.Kuvendi i Komunës së Novobërdës propozon këtë:

Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Novobërdës për vitin 2022

JANUAR	Raporti i Punës së Kuvendit për vitin 2024
	Informatë e Kryetarit mbi planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2025
	Raporti Financiar për vitin 2024. nga drejtoria e financave
	Raporti i Zyres së Auditorit të mbrenshëm mbi realizimin e planit të punës për vitin 2024
	Raporti i Zyres së prekurimit mbi realizimin e planit të prekurimit për vitin 2024
SHKURT	Raporti i punës së Kryetarit për vitin 2024
	Informatë mbi perfundimin e gjysmëvjetorit të parë shkollor dhe pregaditjet për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë shkollor 2024/2025
	Raportimi i Drejtorisë së SH.P për sezonin dimrore gjendja e rrugëve dhe mirëmbajtja.
	Shqyrtimi i Kërkesave të komiteteve ekzistuese.
	Planifikimi i Aktiviteteve rrethë dites nderkomtare të 8 marsit
MARS	Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025
	Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi i mundësive financiare(nga bugjeti i Kuvendit)për kompletimin e administratës së K.K.me mjete të nevojshme të punës si dhe mirëmbajtjen e mjeteve ekzistuese
	Shqyrtimi i Kërkesave të komiteteve ekzistuese.
	Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal

Raporti Financiar i Tre mujorit të parë të vitit 2025

Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal

Raportimi i Punës së Zyrtaris për Integritet europjanë

Shqyrtimi i Kërkesave të komiteteve ekzistuese.

shqyrtimi qështjeve Aktuale-jashtzakonshme

Planifikimi dhe mbajtja e takimeve me qytetaret e komunes për propozim buxhetin per vitin 2026-28.

Raporti i Drejtoris së Bujqësis për mbjelljet pranverore.

Shqyrtimi i qarkores buxhetore të ministris së financave

Shqyrtimi i Kërkesave të komiteteve ekzistuese.

shqyrtimi i qështjeve Aktuale-jashtzakonshme.

Miratimi i kornises afatmesme buxhetore per vitin 2026-28

Shqyrtimi i Buxhetit per vitin 2025

Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal

Raporti Financiar i tre mujorit të dytë per vitin 2025

Shqyrtimi i raportit të zÿres kombtare të auditimit për vitin 2024

Formim nga drejtoria e Arsimit për perfundimin e vitit shkollor 2025/2026, si dhe raportimi mbi suksesin e nxensve.

Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal

Formimi nga drejtoria e financave për qarkoren e dytë buxhetore të MF-ve

KUVENDI SHKON NË PUSHIM

Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të komunës per vitin 2026-2028.

Format nga drejtoria e Bujqësis për perfundimin e fushates së korre-shirjeve

Format nga drejtoria e Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2026/2027

Shqyrtimi i Regullores për Taksa ngarkesa dhe gjoba komunale

Formim nga drejtoria e Inspeksionit për punën e saj në teren

Raportimi i Drejtoris së financave për tre mujorin e tret të vitit 2025

Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal

bledhja solemë
etimi i Kryetarit të Komunes
etimi i Anëtarve të Kuvendit